

# Takim pune i ekipit menaxhues të projektit në kuadër të Këshillit Kombëtar të Pagesave (KKP) për “zvogëlim të pagesave në para të gatshme në Kosovë”

## Procesverbali i mbledhjes

Ref. 10/2013

**Vendi:** Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK)

**Data:** 22 Shkurt 2013

**Koha:** 11:00 – 12:00

### **Pjesëmarrësit:**

**Robert Wright**, *Shef Kryesor Ekzekutiv, RBKO (kryesues);*

**Gjylfidane Kadrijaj**, *Drejtoare e Departamentit të Sistemit të Pagesave, BQK;*

**Boryana Ivanova Mustafa**, *Drejtoare e Pagesave dhe Thesarit, NLB ;*

**Akile Cernobregu**, *Drejtoare e Departamentit të Pagesave, PCB*

**Afrim Gërguri**, *PCB*

**Erik Roka**, *RBKO*

**Besian Demiri**, *TEB;*

**Edmond Murati**, *MPMS;*

**Fatmir Rashica**, *Specialist për Kontroll të Pagesës, KEK;*

**Lindita Mehmeti**, *Udhëheqëse e Departamentit të Operimeve dhe Thesarit, BEK*

**Lumni Rrustolli**, *BQK;*

**Arzen Çavdarbasha**, *BQK*

Takimi filloi në ora 11:00.

### **Diskutimet dhe prezantimet**

- **Miratimi i procesit dhe konkluzioneve të takimit të fundit**

Z. Robert Wright njoftoi të pranishmit me konkluzionet nga takimi i fundit dhe me përmbushjen e tyre. U miratuan procesverbali dhe konkluzionet nga takimi i fundit i mbajtur më 23 Nëntor 2012.

- **U diskutua për hapat e mëtejme në projektin e Qendrës Procesuese ndërbankare**

U njoftuan të pranishmit rreth zhvillimeve në kuadër të projektit të Qendrës Procesuese Ndërbankare, pjesë e Shtyllës së III të Strategjisë së Zhvillimit të Sistemit Kombëtar të Pagesave (SZHSKP). Në këtë kuadër është paraparë edhe asistenca nga Banka Botërore.

Puna në këtë drejtim është ndarë në 4 faza, si hap i parë është hartimi i analizës financiare, pastaj shqyrtimi i kësaj analize financiare, propozimi dhe plani konkret, zhvillimi i projektit dhe si hapi fundit, prokurimi dhe implementimi.

- **Financimi i ekipit për menaxhimin e projektit për zvogëlim të pagesave në para të gatshme**

Në këtë kuadër bankat tanimë kanë dhënë pëlqimin për pjesëmarrje me nga së paku 2000 EUR përfshi edhe BQK. BQK-ja konfirmoj përsëri pjesëmarrjen dhe transferimin e minimum 2000 Euro porsa të hapet llogaria në kuadër të SHBK-ës “*Reduktimi i transaksioneve në para të gatshme*” enkas për qëllim të realizimit të kampanjës për reduktim të transaksioneve me para të gatshme.

VISA ka shprehur gatishmëri për të ndihmuar me një fond për edukimin e klientëve dhe me Master Card, jemi duke i konkretizuar diskutimet për asistencën e tyre (pa kosto).

- **Informacione nga takimet me kompanitë e shërbimeve publike**

Pjesëmarrësit u informuan lidhur me aktivitetet e ndërmarra në drejtim të lehtësimit të përdorimit të instrumenteve të pagesave pa para të gatshme, me theks të veçantë në shtimin e faturës kos giro në versionin 1.5, bardh e zi. Gjithashtu përshtatjet e rregullativës e cila mundëson që autorizimi për DD të nënshkruhet edhe tek banka e klientit. Këto përshtatje janë pranuar nga pjesëmarrësit përveç KEK-ut .

KEK-u është në proces të analizimit të varianteve të cilat janë në diskutim. Për arsye të kalimit të Divizionit të Furnizimit tek operatori i ri pritjet që pas muajit Qershor 2013 të mund të vazhdojë më aktivisht punën në këtë drejtim.

- **Propozimet e nëngrupit të shtyllës së III për Qendrën Procesuese**

Nëngrupi i ekspertëve të lëmisë së kartelave i krijuar nga grupi punues i Shtyllës së III të SZHSKP ka konkluduar se: Tarifatat për transfertat ndërbankare me kartela nga VISA dhe MasterCard nuk janë të larta; se bankat nuk e shohin me interes krijimin e kartelës kombëtare pa brand të VISA dhe/ose MasterCard; largimin nga këto sisteme të pagesave dhe braktisjen e infrastrukturës ekzistuese të tyre për të krijuar një infrastrukturë të re të përbashkët. Krijimi i qendrës nacionale të procesimit të pagesave ma kartela do të kishte shpenzime shtesë mbi ato ekzistueset.

*Propozohet krijimi i sistemit për shlyerje të transaksioneve me kartela bankare në Kosovë (Settlement Agent - në BQK apo ndonjëherë nga bankat komerciale). Bankat duhet të analizojnë mundësinë e uljes së tarifave, të negociohet çmimet dhe licencat dhe produkteve me VISA dhe Master Card.*

- **Asistenca e VISA dhe MasterCard për reduktim të parasë së gatshme në Kosovë**

VISA dhe MasterCard kanë shprehur gatishmërinë të punojnë dhe të asistojnë në këtë drejtim. VISA pret një përshkrim të kërkesave specifike konkrete nga BQK në emër të ekipit që përfshinë bankat, kompanitë dhe institucionet tjera.

- **Konkluzionet e Takimit dhe Hapat e ardhshëm**

- Me VISA do të konkretizohet asistenca, është menduar që kjo asistencë të jetë në drejtim të edukimit /kampanjës për reduktim të parasë së gatshme dhe përdorim të pagesave elektronike. Nga MasterCard, do të kërkojmë në vazhdim përkrahje **pa kosto** për një fushë specifike (anën rregullative, operacionale, apo tjera) nëse pajtohemi bashkë gjatë diskutimeve në vazhdim. Planifikim të buxhetit për këtë qëllim mund të ketë në fazat e mëvonshme për pune konkrete. (BQK dhe ekipi tanimë janë në vazhden e aktiviteteve, analiza e tregut, analiza financiare etj.)
- Deri me 11 Mars, 2013 të përgatitet dhe të dërgohet në “[paymetnsystems@bqk-kos.org](mailto:paymetnsystems@bqk-kos.org)” drafti i kërkesave/nevojave për asistencë nga VISA (nga bankat: PCB,RBKO,NLB,TEB, gjersa BEK, ka njoftuar në BQK, të tjerat banka (BpB, BKT, etj) dhe kompanitë e institucionet do të kontaktohen përsëri nga BQK-ja.  
Anëtarët e grupit punues për zvogëlim të pagesave në para të gatshme të përgjigjen në e-mailin paraprak (dërguar nga BQK me 13 Shkurt 2013)
- Nëngrupi i Shtyllës së III të përgatis dhe të dërgojë analizën mbi Qendrën Procesuese Ndërbankare (teknike, funksionale , financiare) deri në Prill, 2013
- *BQK të organizon takimin me* banka dhe kompani të shërbimeve publike për procedim të mëtejshëm dhe diskutim rreth nënshkrimit të autorizimit tek bankat
- Takimi i ardhshëm do të mbahet në pjesën e parë të Korrikut, 2013 d.m.th. pas sigurimit të mbështetjes së kompanive me përvojë (Master Card dhe Visa) për kushtet dhe mënyrën e asistencës së tyre, pa shpenzime gjatë kësaj faze fillestare. Pas diskutimeve me Bankën Botërore, për asistencë në kuadër të shtyllës III dhe gjithashtu pas finalizimit të raportit statistikor krahasues ([www.http://www.bqk-kos.org/repository/docs/SistemiIPagesave/Raport%20vjetor%20krahasues%20mbi%20instrumentet%20elektronike.pdf](http://www.bqk-kos.org/repository/docs/SistemiIPagesave/Raport%20vjetor%20krahasues%20mbi%20instrumentet%20elektronike.pdf))